



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-21756/2024

Klinë, datë 10/07/2024

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e draft buxhetit për vitin 2025

- CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projekt propozimit- Draft Buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2025. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. Enver Berisha DFEZH, kryesuese;**
 - 1.2. Enver Berisha DUMM, anëtare;**
 - 1.3. Melihate Behramaj, anëtare;**
 - 1.4. Burim Hoti, anëtarë;**
 - 1.5. Vlora Tafili, anëtare;**
 - 1.6. Mirsad Dakaj, anëtarë;**
 - 1.7. Astrit Muhaxheri, anëtarë;**
 - 1.8. Halil Kerellaj, anëtarë, si dhe;**
 - 1.9. Vitore Zefi, OJQ anëtare.**
- Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt propozimit- Draft Buxhetit për vitin 2025, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komune, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
- Me rastin e përgatitjes së draft buxhetit para datës 1 shtator duhet të njoftohet kryetari i komunës lidhur më projekt propozimin më qellim të procedimit të tij në kuvendin e komunës për shqyrtim dhe miratim.
- Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtorja e Financave;
- Zyra e informimit;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

